



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 22/01/2013

Nr. 0104-14

PËR: Ramadan Muja, Kryetar i Komunës së Prizrenit
Njazi Kryeziu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit,

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT, NR. 01/011-11860

Pranuar me datë: 09/01/2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit të miratuar me datë: 18/10/2012, nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili ka efekt të plotë juridik:

- Vendimi Nr.01/011-11860, për themelimin, kompetencat dhe emërimin e Këshillit Komunal për sigurinë e bashkësive.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum, 22.01.2013
Br. 0104-14

Za: Ramadan Muja, Gradonačelnik opštine Prizren
Nijazi Kryeziu, Predsedavajući skupštine opštine Prizren,

Predmet: Potvrda zakonitosti odluka skupštine opštine Prizren

Primljeno dana 09.01.2013.
Br. 11860

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom br. 03/z-040 o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, zakon br. 03/z-049 o finansijama lokalne vlasti, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i ministarstva, nakon razmatranja odluka, odobreno dana 18.10.2011. od strane Skupštine opštine Prizren, **POTVRĐUJE** zakonitost akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi.

Pravni akat sa potpunim pravnim dejstvo je kao što sledi:

- Odluka br.11860, o osnivanju nadležnosti i imenovanja opštinskog saveta o bezbednosti zajednica.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović
Zamenik premijera i ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Direktorima odeljenja i kancelarija
Arhivi MALS-a

Në bazë të nenit 12 pika d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 7, al. 2 të Ligjit për Policinë dhe neit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativë nr. 27/12- 03/2012 të MPB-së së Kosovës, dhe nenit 27, al.1 dhe nenin 58 al.2, të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 18 tetor 2012, mori këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN, KOMPETENCAT DHE EMËRIMIN E KËSHILLIT
KOMUNAL PËR SIGURINË E BASHKËSIVE

Neni 1

Me këtë Vendim, themelohet Këshilli Komunal për Sigurinë e Bashkësive (KKSB), që do të punojë në zbatimin e kompetencave dhe obligimeve të parapara në neni 7 Ligjit për Policinë dhe nenit 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativë nr. 27/12- 03/2012 të MPB-së së Kosovës.

Neni 2

Në këtë Këshill nga neni 1 i këtij Vendimi konform nenit 4 të Udhëzimit Administrativë nr. 27/12- 03/2012 të MPB-së së Kosovës, emërohen: Kryetari i Komunës (që do të jetë dhe Kryesues i KKSB-së), Komandti i Stacionit të Policisë në komunë, nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare, nga një përfaqësues të secilit komunitet (që do të propozojë Kryetari i Komunës), kryesuesi i komitetit për komunitete, zyrtari për barazi gjinore, drejtori i drejtorisë për arsim, kryetari i këshillit të prindërve të arsimit, një përfaqësues i FSK-së, një përfaqësues i secilit këshill lokal për siguri publike, kryesuesi i ekipit veprues për siguri në bashkësi, një përfaqësues nga sektori i emergjencave civile komunale, përfaqësuesi i zyrës komunale për komunitete dhe kthim, një përfaqësues nga OJQ, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara

Neni 3

Për çdo pjesëmarrje në punën e këtij Këshilli, anëtarët e komisionit të emëruar me këtë Vendim do të kompensohen në pajtim me dispozitat e UA.

Neni 4

Punën e Këshillit do ta udhëheqë kryesuesi i Këshillit ndërsa në mungesë të tij zëvendëskryesuesi të cilin do ta caktojë kryesuesi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryesuesi i Këshillit.

Neni 6

Me këtë Vendim do të njoftohen: Të emëruarit dhe Arkivi.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në Web faqen e komunës.

KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi Komunal

Nr. 01/011-11860

Më 18 tetor 2012

Prizren



Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu